



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program **Menaxhimi i mjedisit jetësor**

Fakulteti	Instituti për mjedisin jetësor dhe shëndetin
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	60
Titulli	Magjistër i menaxhimit të mjedisit jetësor
Numri në arkiv i akreditimit [60]	17-119/5
Data akreditimit	18.10.2012

## Përshkrimi i programit

Qëllimet kryesore të programit janë:

- Kontributi në tendencat e mjedisit jetësor që zhvillohen në shoqërinë tonë
- Nxitja e opinionit publik për të zgjidhur problemet mjedisore
- Kërkimi shkencor

## Karriera

Me përfundimin e këtyre studimeve studentët fitojnë 60 ECTS kredi, me çka mund të vazhdojnë studimet e ciklit të tretë. 60 ECTS kreditë e fituara do t'u mundësojnë studentëve të vazhdojnë studimet e tyre në ato institucione të arsimit të lartë në vend dhe jashtë vendit që kanë studime të harmonizuara, ekuivalente dhe/ose analoge sipas procesit të Bolonjës.

## Rezultatet e të mësuarit

### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Proceset natyrore që ndodhin në mjedis.
- Temat e mjedisit si efekti serë, shiu i athtë, ndotja e ajrit.
- Rëndësia e veprimit efektiv për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

### Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Hulumtimet shkencore.
- Njohja e proceseve ekologjike, ekonomike dhe edukativo-arsimore.
- Ndjekja e vazhdueshme e trendeve shkencore botërore.

### Aftësitë për të vlerësuar

- Njohja e koncepteve, strategjive dhe mundësitë e aplikimit të tyre në zgjidhjen e problemeve të caktuara në fushën e

menaxhimit të mjedisit.

- Njohja e marrëdhënieve reciproke midis shoqërisë dhe mjedisit.
- Shkathësitë në mbledhjen, përgatitjen, analizimin dhe prezantimin e të dhënave mjedisore të nevojshme për menaxhim.

### Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për të shkëmbyer në mënyrë të qartë gjetjet dhe propozimet duke i argumentuar dhe duke ofruar mbështetje racionale me njerëz profesionistë dhe joprofesionistë.
- Marrje e përgjegjësisë për rezultatet e përbashkëta, udhëheqje dhe inicim i aktiviteteve.

### Aftësitë e të mësuarit

- Përgatitja e pyetjeve të duhura që çojnë drejt një studimi dhe hulumtimi të suksesshëm.
- Përkufizimi i koncepteve të tilla themelore siç janë: mjedisi jetësor, shoqëria, zhvillimi dhe teknologjia, pastaj aplikimi i përvojave lokale, kombëtare dhe globale.
- Zhvillimi i hipotezave të bazuara në informacione të ekuilibruara, analiza kritike dhe sinteza të kujdesshme dhe testimi i tyre ndaj informacioneve të reja, bindjeve dhe përvojës personale.

## Lista e lëndëve

### Semestri 1

- [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [6.0 SETK] **Sistemet e informacionit për menaxhimin e mjedisit jetësor**
- [6.0 SETK] **Burimet natyrore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 2**

### Semestri 2

- [24.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 1**

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që të njohë studentët me rëndësinë e metodologjisë së kërkimit shkencor, njohjen e thelbit të kërkimit shkencor, metodologjinë e hulumtimit, procedurat dhe llojet e hulumtimit, etj. Vëmendje e veçantë i kushtohet referimit të duhur të nxënësve në thelbin e kërkimit shkencor, interpretimit, vlerësimit të rezultateve të hulumtimit dhe përgatitjes së punimit shkencor. Studentët gjithashtu njihen me procedurën dhe fazat e përgatitjes së tezës së magjistraturës.

- **Sistemet e informacionit për menaxhimin e mjedisit jetësor**

Përfitimi i njohurive të përgjithshme në lidhje me teknologjitë e informacionit, rreziqet dhe ndikimet në mjedisin jetësor dhe shëndetin. Njohuritë specifike për teknologjitë e informacionit dhe mënyrat e vlerësimit të informacioneve dhe teknologjive nga aspekti ekonomik.

- **Burimet natyrore**

Qëllimet e kësaj lënde janë: - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri për mjedisin jetësor, problemet me të cilat ballafaqohet, burimet natyrore, disponibilitetin dhe ripërtëritjen natyrore të tyre, ndotjen e burimeve dhe efektin tyre në mjedisin jetësor. - Roli i njeriut si një faktor kyç në ndotjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore. - Krijimi i shprehive pozitive në lidhje me ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor, vetëdijësimi mjedisor, ruajtja dhe mirëmbajtja e burimeve natyrore. - Përfitimi i njohurive shitesë dhe të avancuara lidhur me politikat kombëtare dhe globale në sferën e mjedisit (burimet natyrore). - Menaxhimi i burimeve natyrore si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm. - Përfitimi i njohurive rreth Strategjisë nacionale të RM për përdorimin racional të burimeve natyrore për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit. Pas punimit të versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor-shkencor formon komision tre anëtarësh, i cili përgatit raport me çka pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor-shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike. Pas kryerjes me sukses të mbrojtjes studenti pajiset me diplomë – Magjistër i menaxhimit të mjedisit jetësor.

## Lëndë zgjedhore

- **Zhvillimi teknologjik dhe mjedisi jetësor**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është t'u mundësojë studentëve të fitojnë shkathtësi më të gjëra për zhvillimin teknologjik dhe teknologjinë e avancuar që përdoret nga kompanitë botërore dhe se si ato ndikojnë në mjedisin jetësor.

- **E drejta mjedisore**

Qëllimi i lëndës është: • T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri të avancuara për të drejtat mjedisore, duke filluar nga korniza ligjore ndërkombëtare e deri te ajo kombëtare. • Studentët gjithashtu do të njoftohen më gjerësisht me legjislacionin ndërkombëtar, standardet dhe normat që duhet të zbatohen nga fusha e mjedisit jetësor. • E drejta mjedisore, pra, do të mësohet si një disiplinë akademike, por edhe perspektivat e saj me problemet konceptuale teorike e praktike dhe me problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë procesit të implementimit të së drejtës mjedisore. • E gjithë kjo, pra, me qëllim të përfitimit të njohurive sa më të avancuara mbi të drejtën mjedisore.

- **Energjia dhe mjedisi jetësor**

Qëllimi i lëndës është: Përfitimi i njohurive të përgjithshme në lidhje me teknologjitë e energjisë, rreziqet dhe ndikimet në mjedisin dhe shëndetin. Njohuritë specifike për energjinë dhe ndryshimet klimatike dhe mënyrat e vlerësimit të teknologjive të energjisë në aspekt mjedisor dhe ekonomik. Së fundi, vënia e njohurive të fituara në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm energjetik.

- **Struktura institucionale dhe bashkëpunimi mbi mjedisin jetësor**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë njohuritë rreth institucioneve vendim-marrëse nga fusha e mjedisit dhe zhvillimit të ekoturizmit, të njihen me strukturën institucionale, me bashkëpunimin reciprok të tyre dhe me bashkëpunimin me institucionet nga fushat e tjera.

- **Ekonomia dhe menaxhimi i mjedisit jetësor**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mjetet ekonomike dhe metodat për analizimin e problemeve themelore të mjedisit jetësor. Paraqet kombinim të analizës teorike me diskutimet e disa politikave mjedisore. Në kuadër të kësaj lënde do të trajtohen edhe tema të analizës mikroekonomike dhe makroekonomike, problemet e shpenzimeve shoqërore, politika e përfortimit të përfitimeve nga mjedisi jetësor, etj.

- **Edukimi mjedisor dhe zhvillimi i qëndrueshëm**

Kjo lëndë ka për qëllim që të rrisë vetëdijësimin dhe kulturën në fushën e mjedisit, përfitimin e njohurive, të vlerave, shkathtësive dhe krijimin e qasjes pozitive ndaj mjedisit jetësor, si një nga shtyllat themelore të zhvillimit të qëndrueshëm.

- **Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit jetësor**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i aftësojë studentët që të njihen me ndërveprimin e organizmave dhe të mjedisit të tyre, me mënyrat e ndotjes e të mbrojtjes prej sak dhe me mundësitë për përfshirjen aktive në mbrojtjen e mjedisit. I përgatit studentët me studime bashkëkohore dhe kujdeset për përsosje profesionale nga fusha e mjedisit jetësor.

- **Kapituj të zgjedhur nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: • T'u tregojë studentëve elementet teknike, strukturën e tekstit dhe përpunimin e një punimi shkencor. • T'u mundësojë të fitojnë njohuri dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI, të nevojshëm për përgatitjen e punimeve shkencore. • Zbatimin praktik të këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimeve individuale të studentit.

- **Aplikacione për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: • T'u tregojë studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimit, përpunimit, zbatimit përmes analizave dhe publikimit të të dhënave. • T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe shkathtësi nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave. • Zbatimin praktik të këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, raportet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.